



Zgjedhjet Lokale 2009

***Komunikatë për shtyp – për publikim të menjëhershëm
16.10.2009, Prishtinë***

ENEMO fillon vëzhgimin e zgjedhjeve lokale 2009 në Republikën e Kosovës

Misioni i ENEMO-s është vëzhgimi i zgjedhjeve lokale 2009 në Republikën e Kosovës. Zyra qendrore është hapur në Prishtinë dhe përbëhet nga 7 anëtarë kryesorë. Anëtarët janë duke u përgatitur për ardhjen e 12 vëzhguesëve afatgjatë dhe 120 vëzhguesëve afatshkurtër nga shtetet anëtare të OSBE-së.

Misioni i ENEMO-s udhëheqet nga z. Darko Aleksov, drejtor egzekutiv i Asociacionit të Qytetarëve MOST nga Republika e Maqedonisë.

Vëzhguesit afatgjatë dhe afatshkurtë do të informohen dhe do të veprojnë në ekipe prej dy anëtarëve. Ekipet do të vendosen në rajone të ndryshme në mënyrë që të mbulojnë të gjithë territorin e Republikës së Kosovës gjatë dy rundeve të zgjedhjeve.

"Vëzhguesit e ENEMO-s do të vëzhgojnë dhe vlerësojnë, zbatimin brenda kuadrit ligjor të aspekteve të mëposhtme të procesit zgjedhor: punën e administratës zgjedhore, aktivitetet e fushatës, votimin, numërimin e votave dhe nxjerrjen e rezultateve, si dhe menaxhimin e procedurës së ankesave dhe apeliemeve," theksoi z. Aleksov.

Si një nga miratuesit, ENEMO aplikon standarde të larta të përcaktuara në "Deklaratën e parimeve për vëzhgim ndërkombëtar të zgjedhjeve dhe kodin e sjelljes për vëzhguesit ndërkombëtarë." Vëzhguesit e ENEMO-s veprojnë dhe kryejnë punën e tyre në përputhje me këtë deklaratë.

"Qytetarët e Kosovës dhe autoritetet e saj, nëpërmjet organizimit të zgjedhjeve të lira dhe të ndershme si dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare, do të kenë mundësi unike për të manifestuar pjekuri demokratike dhe vetëdije qytetare," tha z. Aleksov.

ENEMO (Rrjeti Evropian i Organizatave Monitoruese të Zgjedhjeve) është një grup prej 18 organizatave qytetare nga shtatëmbëdhjetë vende të Evropës Qendrore dhe Lindore dhe ish-Bashkimit Sovjetik. Këto organizata jopartiake janë organizata udhëheqëse për monitorimin e zgjedhjeve vendore në vendet e tyre. Në total, organizatat anëtare të ENEMO-s kanë vëzhguar 200 zgjedhje kombëtare në vendet e tyre, më shumë se 100 zgjedhje jashtë vendit dhe kanë trajnuar 200,000 vëzhgues të zgjedhjeve.

Misioni i vëzhgimit të zgjedhjeve deri tani është mbështetur bujarisht nga USAID-i përmes Institutit Nacional Demokratik për Çështje Ndërkombëtare (NDI), Ambasada e Mbretërisë së Holandës dhe Qeverisë së Suedisë.

Për më shumë informata:

ENEMO Election Observation Mission – Zyret qendrore
Andrea Gropa Nr. 1, 10000 Pristina
E-mail: press@enemo.eu
Tel: +386 (0) 49-205-817